



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. KPD1917812024
Nr. Iq/Br. Stu./Nr. pg. 0311212024
Data/Datum/Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA-PRIŠTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitat në stacionet policore

Drejtuar: Z. Xhelal Sveçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 3 dhjetor 2024

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (MKP) e ka vizituar pikën e kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë.

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në mandatin e saj, MKP-ja ka vizituar stacionet policore si në vijim:

- *Stacioni Policor në Shtërpçë*
- *Stacioni Policor “Qendra”*
- *Stacioni Policor në Podujevë*
- *Stacioni Policor në Istog*
- *Stacioni Policor Drenas*
- *Stacioni Policor Skenderaj*
- *Stacioni Policor Mitrovicë – Jugu*
- *Stacioni Policor Mitrovicë – Veri*
- *Stacioni Policor Malishevë*
- *Stacioni Policor Rahovec*
- *Stacioni Policor Gjakovë*
- *Stacioni Policor Gjilan*
- *Stacioni Policor Graçanicë*

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i vizitës në stacionet e lartpërmendura policore ishte për të vlerësuar se a janë respektuar tri të drejtat themelore të personave të arrestuar: E drejta për ta njoftuar anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për faktin e arrestimit; E drejta për avokat mbrojtës; E drejta për shërbime mjekësore si dhe kushtet e akomodimit në qendrat e ndalimit policor. Këto të drejta janë të përcaktuara dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës.

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitave

1. Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKP-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat në çdo stacion policor. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe qasje në të gjitha dokumentet e kërkuar, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar, pa praninë të zyrtarëve policorë.

Garancitë kundër keqtrajtimit

2. Të drejtat e personave të arrestuar nga Policia e Kosovë janë të përcaktuara dhe të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në Raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, kishte theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: E drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); E drejta për të pasur një avokat; E drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹

4. Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.

5. Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës këto të drejta themelore të personave të arrestuar dhe në mbajtje nga autoritetet policore i parashev edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.

Trajtimi

6. MKP-ja ka realizuar intervista me disa persona që ishin në mbajtje në stacionet policore të lartcekura, por nuk ka marrë ankesa për përdorim të forcës nga zyrtarët policorë, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në qendrat e ndalimit. Për më tepër, ka pasur disa pohime nga të ndaluarit se ndaj tyre zyrtarët policorë kanë pasur trajtim profesional dhe shumë korrekt nga në qendrat e ndalimit. Po ashtu, të ndaluarit nuk kanë pohuar se u janë mohuar edhe të drejtat themelore, si: qasja në avokat, qasja në shërbime shëndetësore dhe njoftimi i familjes, të drejta të cilat janë të garantuar më legjislacioni në fuqi në Republikës e Kosovës.

7. Përveç kësaj, MKP-ja gjatë vizitave në stacionet policore të lartpërmendura ka shqyrtau dokumentacionin relevant dhe ka vërejtur se të gjitha stacionet policore e posedojnë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit/ndaluarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 170 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Kushtet fizike në këto stacione policore

8. Bazuar në Procedurat Standarde të Operimit (PSO), qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Rekomandimet e KPT-së, duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.²

9. Më 1 shkurt 2024, gjatë vizitës në **Stacionin Policor në Shtërpçë**, MKP-ja ka vërejtur se stacioni policor është rinovuar në tërësi. Po ashtu është rinovuar edhe Qendra e Ndalimit në këtë stacion, në përbërje të të dy dhomave, njëra përfshirë femra me një krevat dhe tjetra përfshirë krevat. Dhomat kishin hapësirë, ndriçim artificial dhe natyral të mjaftueshëm. Për sa u përket kamerave, ende nuk ishin funksionale, pasi edhe vetë Qendra e Mbajtjes ende nuk ishte funksionalizuar dhe pritej të funksionalizohej.

¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

² Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit përfshirë Qendrat e Ndalimit, DDO-04/0121/2016, pika 1.6, faqe 4.

10. Më 14 mars 2024, MKP-ja gjatë vizitës në **Qendrën Rajonale të Ndalimit në Prishtinë**, ka vërejtur se pesë qeli ku mbahen personat e arrestuar ishin jashtë funksionit, për shkak të problemeve që kishin nga rrjedhja e ujit, e cila shkaktohej nga tubacionet e ngrohëseve. Bazuar në pohimet e zyrtarëve policorë, ky problem zgjat nga fillimi i sezonit të ngrohjes e deri në përfundim të sezonit të ngrohjes. Gjithashtu MKP-ja ka vërejtur se në qelitë e të arrestuarve, të cilat ishin funksionale, qëndrimi në këto qeli ishte pothuajse i papërballueshëm nga nxehësia e madhe si dhe nga mungesa e ndriçimit natyral.

Po ashtu duhet cekur se as kushtet e zyrtarëve policorë në këtë Qendër nuk ishin të mira, për shkak të këtyre problemeve si dhe mungesës së ndriçimit natyral.

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës në stacionin policor të lartpërmendor ka zhvilluar takim me majorin B. B., i cili pohoi se për sa i përket ndërtimit që parashihet të bëhet (Aneks shtesë në DRP-në e Policisë, Prishtinë), buxheti për realizim të projektit eshtë i ndarë dhe aktualisht projekti eshtë në fazën e vlerësimit të ofertave sipas Ligjit të Prokurimit. Këto pohime nga major B. B., ekipi i MKP-së i ka pranuar edhe nëpërmjet adresës elektronike zyrtare.

11. Më 12 prill 2024, gjatë vizitës në **Stacionin Policor në Podujeve**, ekipi i MKP-së ka vërejtur se për sa u përket kushteve në Qendrën së Ndalimit në këtë stacion, janë të kënaqeshe, pasi pastërtia ishte në nivel, kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm, kishte ajrosje, kamerat ishin funksionale, shtroja e mbuloja pastroheshin çdo ditë, përvèçse nuk kishin mjete higjenike të mjaftueshme për të ndaluarit.

Stacioni Policor në Podujeve kishte dhomën miqësore, e cila ishte në gjendje të mirë dhe i plotësonte kushtet për intervistimin e prindërve dhe qëndrim të fëmijëve. Mirëpo në këtë stacion, zyrat e hetuesve nuk ishin në gjendje të mirë dhe kishin filluar disa punime në shtrimin e laminatit nga vetë zyrtarët policorë, inventari ishte shumë i vjetruar, ndërsa vetë zyrtarët i kishin gëlqerosur zyrat me mjete vetjake. Kondicionerët nuk punonin dhe gjatë kohës së verës temperaturat në stacion ishit të padurueshme. Po ashtu, në këtë stacion nuk kishte furnizim të mjaftueshme më ujë të pijes. Për sa u përket mjeteve të punës, në këtë stacion nuk funksiononte printeri, po ashtu kishte mungesë të veturave si dhe sprej, si mjet pune nuk kishte afat që dy vjet.

12. Më 25 prill 2024, MKP-ja ka vizituar **Stacionin Policor në Istog**, ku ka vërejtur se Qendra e Ndalimit në këtë stacion ka katër (4) dhoma për të ndaluarit, dy me nga dy krevate dhe dy me nga një krevat. Dhomat e ndalimit kishin ndriçim natyral, artificial dhe ajrosje të mjaftueshme. Për sa u përket mjeteve të punës, togeri ka shfaqur pakënaqësi për shkak të mungesës se mjeteve të transportit dhe mungesës së materialit higjenik për zyrtarët policorë dhe për të ndaluarit.

13. Më 21 maj 2024, KMP-ja ka vizituar **Stacionin Policor në Drenas**, me ç' rast ekipi i MKP-së eshtë njoftuar dhe ka vërejtur se gjendja në këtë stacion eshtë e njëjtë, për shkak se deri më tani nuk ka pasur asnjë veprim për sajimin e problemit i cili shkaktohet nga prania e pusit të ujërave të zeza, i cili ndodhet brenda Qendrës së Ndalimit. Ky pus shpesh ka rrjedhje të ujërave të zeza, duke krijuar një erë shumë të keqe që e bën të pamundur qëndrimin në qendër, si për stafin policor ashtu edhe për personat e ndaluar. Mosfunkcionimi i kësaj qendre eshtë një sfidë serioze, pasi të gjithë të ndaluarit duhet të transportohen në qendrat e tjera të stacioneve të policisë, gjë që konsumon kohë për stafin dhe shkakton ngecje në kryerjen e detyrate të punës.

14. Më 21 maj 2024 MKP-ja ka vizituar **Stacionin Policor në Skenderaj**, ku ekipi i MKP-së ka vërejtur se është në funksion Qendra e Ndalimit në këtë stacion, e cila përbëhej prej tri dhoma. Kushtet në këto dhoma ishin relativisht të mira. Dhomat kishin ndriçim natyral dhe artificial, po ashtu kishte dyshekë, shtrojë e mbulojë, si dhe gjatë dimrit është aktive ngrohja nëpër dhoma.

15. Më 21 maj 2024 MKP-ja ka vizituar **Stacionin Policor në Mitrovicë – Jugu**, me ç’ rast ekipi i MKP-së është informuar dhe ka vërejtur se Qendra e Ndalimit në këtë stacion ka gjashtë dhoma, por tri dhoma me pesë shtretër nuk janë aktive. Gjendja e dhomave joaktive është e tillë që nuk lejon përdorimin e tyre të sigurt dhe të rehatshëm për të ndaluarit, si p.sh. lagështia, dëmtimet strukturore, problemet me sistemin e ventilimit etj. Ndërsa gjendja e dhomave aktive ishte relativisht e mirë. Gjithashtu ekipi është informuar se të gjithë të ndaluarit e komunës së Mitrovicës së Veriut sillen në këtë qendër, pasi Qendra e Ndalimit në Stacionin Policor në Mitrovicën e Veriut është jashtë funksionit. Njëkohësisht kjo situatë shkakton sfida për kapacitetet ekzistuese të Qendrës.

16. Më 21 maj 2024 MKP-ja ka vizituar **Stacionin Policor në Mitrovicë – Veriu**, në kuadër të kësaj vizite ekipi është njoftuar nga komandanti i stacionit se Qendra e Ndalimit në këtë stacion ka qenë gjithmonë jashtë funksionit dhe vazhdon të jetë e tillë. Kjo ndodh për shkak se Qendra nuk i plotëson kriteret e nevojshme dhe nuk ka pasur ndonjë investim për përmirësimin e saj.

Arsyeja kryesore për mungesën e investimeve është fakti se stacioni policor ndodhet në një objekt që është pronë e ndërmarrjes “Trepça” dhe nuk është e qartë se sa kohë do të mundë të qëndrojnë në atë objekt. Gjatë vizitës është vërejtur se Qendra e Ndalimit është duke u shfrytëzuar si depo, duke dëshmuar kështu gjendjen e saj jashtë funksionit për qëllim të ndalimit të personave.

17. Më 31 korrik 2024 MKP-ja e ka vizituar **Stacionin Policor në Gjakovë**, stacion i cili posedon Qendrën e Ndalimit, mirëpo gjatë kohës së monitorimit ishin funksionale vetëm tri dhoma të ndalimit, më nga një shtrat. Ndërsa tri qeli të tjera më nga dy shtretër ishin jashtë funksionit si rrjedhoje e defektit të kanalizimit.

18. Më 23 shtator 2024 MKP-ja e ka vizituar **Stacionin Policor në Malishevë**, stacion i cili posedonte pesë dhoma ndalimi, për një periudhë kanë qenë funksionale, mirëpo aktualisht asnjë nga dhomat e ndalimit nuk është funksionale, për shkak të prishjes së kamerave dhe kushteve të papërshtatshme të vendosjes së të ndalurve në to. Si rezultat, të ndaluarit transferohen në qendrat e ndalimit në Rahovec dhe në Gjakovë. Objekti i Stacionit Policor në Malishevë ka kushte të dobëta, pasi është ndërtuar gjatë viteve ‘90 dhe ka pasur vetëm një rinnovim të pjesshëm pas luftës.

19. Më 23 shtator 2024 MKP-ja e ka vizituar **Stacionin Policor në Rahovec**, stacion i cili e ka Qendrën e Ndalimit me kushte relativisht të mira. Dhomat e ndalimit kanë ndriçim natyral dhe artificial si dhe dyshekë, po ashtu sistemin e ngrohjes e kishin aktiv gjatë dimrit.

20. Më 3 tetor 2024 MKP-ja e ka vizituar **Stacionin Policor në Gjilan**, Qendrën e Ndalimit në këtë stacion ishte relativisht e mirë. Shqetësuese është së në këtë stacion nuk funksiononin kamerat e sigurisë si dhe mungesa e mjeteve higjenike. Po ashtu gjatë vizitës si shqetësim është theksuar edhe puna e ndërrimit të natës, pasi sipas zyrtarëve policorë, në mungesë të stafit, ka raste kur në ndërrim të natës punon vetëm një femër. Në këto rrethana, kur ka raste vështirë të menaxhueshme, vjen në ndihmë ndonjë zyrtar nga policia.

21. Më 4 tetor 2024 MKP-ja e ka vizituar **Stacionin Policor në Graçanicë** dhe ka vërejtur se Qendra e Ndalimit në këtë stacion ishte jofunksionale, për shkak se ishte duke u rrinovuar. Qendra e Ndalimit kishte dy dhoma me nga dy shtretër dhe dy dhoma më nga një shtrat, dhomat kishin ndriçim natyral dhe artificial. Mirëpo kamerat e sigurisë nuk ishin funksionale në Qendrën e Ndalimit, por pritet të instalohen së shpejti. Po ashtu, komandanti i Stacionit ka pohuar se kanë probleme me mjetet higjenike dhe printerë. Përveç kësaj, në këtë Stacion ishte krijuar edhe Dhoma Mike për rastet e dhunës në familje, e që ishte donacion nga UNHCR-ja.

22. Duhet cekur se në të gjitha stacionet e lartcekura që janë vizituar, ekipi i MKP-së ka vërejtur se asnjëherë në Dhomat e Ndalimit nuk është i instaluar sistemi i thirrjes (zilja).

23. Për sa u përket broshurave ku janë të ilustruara të drejtat e njeriut, në disa Qendra të Ndalimit të lartcekura ishin të vendosura në mure të drejtat e të ndaluarve, mirëpo në disa nuk ishin të vendosura. Lidhur me këtë, zyrtarët policorë kanë pohuar se vazhdimisht i vendosin broshurat për të drejtat e personit të ndaluar, por ato hiqen, grisen nga vetë të ndaluarit.

24. Gjithashtu duhet cekur se edhe gjatë vizitave brenda këtij viti në stacionet e lartcekura, MKP-ja është njoftuar se zyrtarët policorë, problemin më të madh e kanë me personat që janë përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor, dhe këto kategori po ua vështirësojnë shumë punën, pasi janë vështirë të menaxhueshëm dhe pandërprerë për 48 orë duhet të vëzhgohen, nga frika e tentimit për vetëlëndim/vetëvrasje. Këta persona po paraqesin rrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për t'i trajtuar këto kategori të të ndaluarve.

25. Po ashtu, në të gjitha stacionet lartcekura MKP-ja ka marrë ankesa për sa u përket kushteve të punës së zyrtarëve policorë si dhe stacionet policore po ashtu edhe në Qendrat e Ndalimit, si stazhi i beneficuar, sëmundjet kronike të zyrtarëve, shujtë, inventarin e vjetruar, si dhe mungesën e materialit higjenik. Si shqetësim në të gjitha stacionet ishte edhe mungesa e fotokopjes apo prishja e shpeshtë dhe çështja e printerit që pothuajse në çdo stacion po e pengon procesin e punës. Problem i veçantë është edhe mungesa e veturave. Edhe ato vutura që i posedojnë, janë shumë vjetra dhe të demoluara.

Kujdesi shëndetësore

26. Për sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: qendra e mjekësisë familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e intervistuar. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtaur është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet personale të të ndaluarve njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

27. Për më shumë, MKP-ja ka vërejtur një praktikë shumë pozitive në shumicën e stacioneve policore, ku të arrestuarit e mitur dhe ata madhorë, para se të dërgohen në ndalim, dërgohen për kontolle mjekësore në qendrën më të afërt të mjekësisë familjare.

Ushqimi

28. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton obligimin që nëse personi i privuar nga liria mbahet më shumë se 12 orë, duhet t'i sigurohen tri racione ushqim në ditë.³

³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nen 168, paragrafi 3. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>

Personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqim brenda 24 orëve, sipas kontratës që ka Policia me kompaninë kontraktuese. Mirëpo, për sa i përket ushqimit në shumicën e stacioneve policore të lartcekura, MKP-ja është njoftuar nga zyrtarët policorë se të arrestuarit kanë shprehur shqetësimë lidhur me ushqimin jocilësor dhe pamjaftueshmë për nga sasia, që u ofrohet sipas kontratës që ka Policia me kompaninë kontraktuese.

Parashtrimi i ankesave nga personat e arrestuar

29. Lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, personat e arrestuar kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa në stacionin policor ku mbahen, në Inspektoratin Policor të Kosovës, si dhe tek organet e jashtme monitoruese, siç janë: MKP-ja dhe organizatat joqeveritare, të cilave u lejohen vizitat në vendet e privimit nga liria. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesave në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka vendosur kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtje të të arrestuarve. Këto kuti të ankesave hapen vetëm nga personeli i caktuar i Avokatit të Popullit. Vlen të ceket se këto kuti janë hapur nga zyrtarët e Avokatit të Popullit në regjione, mirëpo asnje ankesë nuk është vendosur në këto kuti nga të ndaluarit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

30. Avokati i Popullit, nga të gjeturat gjatë vizitave në stacionet e lartcekura, vëren së në të gjitha qendrat e ndalimit, saktësisht në dhomat (qelitë) e ndalimit, nuk është i instaluar sistemi i thirrjes (zilja). Avokati i Popullit konstaton së në mungesë të sistemit të thirrjes (ziles), ekziston një rrezik i konsiderueshmë se policia nuk mund të ndërhyjë në kohën e duhur në rast incidentesh të ndryshme (dhunë midis personave të ndaluar, tentativë vetëvrasje, zjarr, kërkesa shëndetësore etj.). Andaj instalimi i sistemi të thirrjes mundëson dhe garanton që personat e ndaluar të kenë një siguri dhe komunikim me të shpejtë dhe më të mirëfilltë me stafin mbikëqyrës policor.

31. Avokati i Popullit nga të gjeturat konstaton se në disa qendra të ndalimit mungonin broshura dhe karta të varura në mur, ku ilustroheshin të drejtat e njeriut të ndaluar në polici. Pavarësisht se personat e ndaluar njoftohen për drejtat e tyre gjatë intervistimit, përmes formularit të nënshkruar, Avokati i Popullit konsideron se edhe vendosja në dhomat e ndalimit e broshurave dhe e kartave për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar do t'i mundëson personit të ndaluar një njoftim më të qartë për të drejtat e tij.

32. Avokati i Popullit, për sa u përket kushteve materiale të qendrave të ndalimit, nga të gjeturat e lartcekura konstaton se qendrat e ndalimit në stacionet policore në Prishtinë, Drenas, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Gjakovë dhe Malishevë duhet të sanohen të gjitha defektet, po ashtu të rinovohen dhe të funksionalizohen për pranimin dhe mbajtjen e personave të ndaluar, sipas standardeve minimale të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.⁴ Po ashtu Avokati Popullit konstaton se zyrat e marrjes në pyetje në Stacionin Policor në Podujevë duhet të rregullohen dhe të rinovohen sipas këtyre standardeve.

33. Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha stacionet policore ka pasur mungesë të mjeteve higjenike.

⁴ <https://rm.coe.int/16806cd1d5> paragrafi 47.

34. Ndërsa, për sa i përket funksionalizimit të kamerave në qendrat e ndalimit, Avokati i Popullit vëren se në stacionet policore në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Avokati i Popullit konstaton se mosfunksionalizimi i kamerave në stacionimet në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë paraqet irrezik për keqtrajtim të personave në ndalim, andaj sa më shpejt të jetë e mundur duhet të funksionalizohen kamerat e sigurisë në këto qendra të ndalimit.

35. Avokati i Popullit konstaton se ushqimi për të ndaluarit është jocilësor, i thatë dhe i pamjaftueshëm për nga sasia në të gjitha qendrat e ndalimit të vizituara.

36. Avokati i Popullit konstaton se zyrtarët policorë në stacionet policore të lartcekura problemin më të madh e kanë me personat që janë përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor dhe këto kategori po ua vështirësojnë shumë punën, pasi janë vështirë të menaxhueshëm dhe pandërprerë për 48 orë duhet të vëzhgojen, nga frika e tentimit për vetëlëndim/vetëvrasje. Këta persona po paraqesin irrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për t'i trajtuar këto kategori të të ndaluarve.

37. Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha stacionet policore ka pranuar shqetësime dhe ka vrenjtur se kushtet e punës të zyrtarëve policor në shumicën e stacioneve të lartcekura janë të pafavorshme për punë, pasi ka mungesë të inventarit, të printerëve, të mjeteve higjenike dhe të veturave.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitave në stacionet policore të lartcekura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- *Të gjitha qendrat e ndalimit në stacionet policore të lartcekura të pajisen me sistemin e thirrjes - zilen e thirrjes.*
- *Në të gjitha dhomat/qelitë në qendrat e ndalimit të vendosen në mure kartat për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar.*
- *Të sanohen problemet dhe të funksionalizohen qendrat e ndalimit në stacionet policore në Prishtinë, në Drenas, në Mitrovicën e Jugut, në Mitrovicën e Veriut, në Gjakovë, në Shtërpcë dhe në Malishevë.*
- *Të ndaluarit të furnizohen me mjete të mjafaftueshme higjenike.*
- *Të funksionalizohen kamerat e sigurisë në stacionet policore në Shtërpcë, në Gjilan dhe në Graçanicë.*
- *Të ndaluarit të ushqehen me ushqim cilësor dhe të bollshëm.*
- *Të mbahen trajnime adekuate për stafin policor për trajnimit e personave të ndaluar me sëmundje mendore.*
- *Të krijohen kushtet e punës për zyrtarët policorë, të pajisen me inventar adekuat (karrige, tavolina), me printerë, me mjete higjenike dhe me vetura.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i

detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkura në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e vprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për vprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësish të na informoni për vprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

